



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORCE

VENDIM

Nr. 113 Date 11.12.2009

Për Miratimin e Huasë Bankare për Financimin e disa projekteve të rëndësishme infrastrukturore në qytetin e Korces

Bazuar në Ligjin numër 8652, datë 31.07.2000, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore" dhe Ligjin numër 9869, datë 4.02.2008, "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore" neni 7, pikat 1 dhe 2 të tij dhe Udhëzimit numër 35, datë 5.11.2008 të Ministrit të Financave "Për Zbatimin e Ligjit nr. 9869, datë 4.02.2008, "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore" me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe pas diskutimeve të keshilltareve, Këshilli Bashkiak Korce,


Vendosi:

1. Të miratojë marrjen e huasë bankare për financimin e projektit (I)Ndertimi i Zones Kembesore (I cili përfshin Shetitoren Shen Gjergji dhe sheshin para Katedrales); (II)Zgjidhja e kryqezimeve në Shetitoren "Fan Noli", (III) Vazhdim dhe përfundim i punimeve në Bulevard Republika, (IV) përmirësim i infrastrukturës rrugore të qytetit,)
2. Qëllimi për të cilin merret huaja është financimi i disa projekteve të rëndësishme infrastrukturore në qytetin e Korces. (I)Ndertimi i Zones Kembesore((I cili përfshin Shetitoren Shen Gjergji dhe sheshin para Katedrales); (II)Zgjidhja e kryqezimeve në Shetitoren "Fan Noli", (III) Vazhdim dhe përfundim i punimeve në Bulevard Republika, (IV) përmirësim i infrastrukturës rrugore të qytetit,)
3. Shuma e huasë 300 milionë lekë;
4. Norma vjetore e interesit në lekë do të jetë e rishikueshme prej Bono Thesari 12 mujore + 0.5%, minimumi 8%;
5. Forma e huasë është hua nga tregu bankar / Banka Procredit;
6. Maturimi 10 vjet;
7. Mënyra e kthimit të saj është me pagesa tremujore sipas skemës së amortizimit të propozuar nga banka fituese pjesë e kontratës së huasë;
8. Garanci për kthimin e huasë vendosen të ardhurat e pakushtëzuara të bashkisë;
9. Janë respektuar të gjitha kriteret kufizuese të borxhit sipas kreut IV të ligjit numër 9869, datë 4.02.2008 "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore", të cilat janë:
 - Kufizimi i stokut - huaja e marrë të jetë maksimumi 731 milionë lekë. Shuma totale e cila merret borxh është 300 milionë lekë (brenda këtij kufiri);

- Shërbimi i borxhit për vitin 2010 të jetë maksimumi 48,06 milionë lekë. Shërbimi i borxhit për vitin 2010 parashikohet rreth 47,90 milionë lekë (brenda këtij kufiri). Gjithashtu edhe shërbimet e borxhit për vitet e tjera deri në maturim të plotë të saj të përlogaritura saktë sipas formulës së ligjit janë më të mëdha sesa shërbimi vjetor i borxhit për këto vite i propozuar në ofertën e bankës fituese.
10. Koha e dobishme e përdorimit të projekteve infrastrukturore që financohen nga kjo hua është 20 vjet.
11. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

KRYETARI

GJERGJI PENDAVINJI



Dixhitalizuar nga Qendra Qilind
www.infocip.org